

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Avdi Dinaj-anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit I. S. nga Ferizaji, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291.par.6.lidhur me par.4.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PK.nr.42/2016 të datës 14.04.2016. dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.485/2016 të datës 18.07.2016., në seancën e mbajtur më 03.10.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit I. S. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PK.nr.42/2016 të datës 14.04.2016. dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.485/2016 të datës 18.07.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.635/2013 të datës 29.07.2014. i dënuari I. S. është shpallur fajtor për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291.par.6.lidhur me par.4.të KPK dhe është gjykuar me dënim me kusht me të cilin i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) vitesh nga plotfuqishmëria e

aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale dhe me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) €, të cilin është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Aktgjykimi ka marrë formën e prerë më datën 20.08.2014.

Kundër këtij aktgjykimi mbrojtësi i të dënuarit ka paraqitur kërkesë për rishikimin e procedurës penale e cila është hedhur si e palejuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PK.nr.42/2016 të datës 14.04.2016.

Në procedurën ankimore, me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.485/2016 të datës 18.07.2016. është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të dënuarit dhe aktvendimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve mbrojtësja e të dënuarit, avokatja L. Q.-I. nga Ferizaji, ka paraqitur kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në vendimmarrje dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.171/16 të datës 09.09.2016. ka propozuar që kërkesa të hedhet si e palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme nga shkresat e lëndës dhe nga aktvendimet e kundërshtuara konstatojë se i dënuari është shpallur fajtor për atë se në kohën kritike në vendin kritik, duke mos vepruar sipas rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse, nga pakujdesia ka

shkaktuar rrezik për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që në objektin në ndërtim të sipër, e si pronar i objektit, në aktin përdhese ka lënë një hapësirë të hapur dhe të mbyllur me dërrasa dhe paleta druri dhe tani i ndjeri B. V. derisa kishte dashur që të hynë në një veturë, ka rënë dhe si pasojë e lëndimeve të pësuar trupore, ka vdekur në spital pas dy dite.

Para gjykatës së shkallës së parë i dënuari ka pranuar fajësinë dhe gjykata këtë pranim të fajësisë e ka aprovuar.

Nga aktvendimi i shkallës së parë rezulton se pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, mbrojtësi i të dënuarit ka paraqitur kërkesë për rishikimin e procedurës penale dhe kjo kërkesë, me aktvendimin PK.nr.42/2016 të datës 14.04.2016. është hedhur si e palejuar, konform dispozitës së nenit 426.par.1.pika 2.të KPPK me arsyetim se prova e cila është paraqitur në kërkesën për rishikimin e procedurës penale nuk justifikon lejimin e përsëritjes së procedurës. Është thënë se fakti se i dënuari pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit ka prezentuar provë se nuk ka qenë pronar i objektit në të cilin ka ndodhur vepra penale, nuk ka ndikim në aplikimin e drejt të ligjit, sepse është vërtetuar se ai ka pas kontroll efektiv mbi pronën në të cilin ka ndërtuar objekt dhe ka pas për obligim të ndërmerr masat mbrojtëse të cilat janë standard teknik e duke mos vepruar kështu, nga pakujdesia, ka kryer veprën penale për të cilën ka qenë i akuzuar. Arsyet e këtilla i ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendohet se arsyet e dhëna në që të dy aktvendimet nuk qëndrojnë, sepse i dënuari nuk ka qenë titullar i pronës në vendin ku ka ndodhur ngjarja kritike dhe janë bashkëngjitur prova materiale-aktvendimi për ndarjen fizike të pronës të Gjykatës komunale në Ferizaj Nd..... datës, parashtresa e Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe kontrata për shitblerjen e patundshmërisë, nga të cilat vërtetohet se i dënuari nuk është pronar i kësaj patundshmërisë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, si në aktvendimin e shkallës së parë ashtu edhe në atë të shkallës së dytë, janë dhënë arsye ligjore për marrjen e vendimeve të kundërshtuara.

Për ekzistimin e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, nuk kërkohet që ai të jetë pronarë i patundshmërisë në të cilën ka ndodhur vepra penale por të jetë person zyrtar ose person përgjegjës, i cili, në kundërshtim me dispozitat për detyrat e punës së tij, (mes tjerash) nuk vepron sipas rregullave ose rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse dhe me këtë shkakton rrezik për jetën e njerëzve apo për pasuri me vlerë thelbësore. I dënuari ka pranuar fajësinë për veprën penale ashtu siç ka qenë e përshkruar në aktakuzë, pra, se nga pakujdesia, ka lënë hapësirë të pambrojtur në objektin të cilin e ka ndërtuar që ka rezultuar me pasojën e cekur më lartë. Andaj, pa marrë parasysh se nuk ka qenë pronar i patundshmërisë në të cilin është ndërtuar objekti, ai ka qenë person i cili objektin e ka ndërtuar, gjegjësisht përgjegjës për ndërtimin e objektit dhe për masat mbrojtëse të cilat nuk ka i ndërmarr.

Andaj, me të drejt është konstatuar në aktvendimin e shkallës së parë se prova në të cilën bazohen kërkesa për rishikimin e procedurës penale e që ka të bëjë me atë se i dënuari nuk ka qenë pronar i patundshmërisë në të cilin është ndërtuar objekti, nuk justifikon lejimin e rishikimit të procedurës penale e këtë e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë.

Që të dy aktvendimet kanë arsye ligjore për bazën e hedhjes se kërkesës për përsëritje të procedurës penale dhe për refuzimin e ankesës së paraqitur kundër këtij vendimi.

Kjo gjykatë konstatojë se nuk mund të jenë lëndë e vlerësimit pretendimet se të dënuarit nuk i është caktuar mbrojtësi sipas detyrës zyrtare edhe pse ai si person i pashkolluar nuk ka qenë në gjendje të mbrohet me sukses dhe se në shkresat e lëndës nuk ka pas prova të cilat kanë justifikuar aprovimin e pranimit të fajësisë, sepse këto kanë të bëjnë me procedurën e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë, kundër të cilave nuk është paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë por ajo është paraqitur vetëm kundër aktvendime me të cilat është vendosur për kërkesën për rishikimin e procedurës penale.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 227/2016, më 03.10.2016.

Proçesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka